


**KOSOVA DHE PROGRAMI I SHBA-SË MBI SISTEMIN E PËRGJITHËSUAR TË PREFERENCAVE
(SPP):
SI TË SHFRYTËZOHEN PËRFITIMET E SPP-SË PA DOGANË
MARS 2009**

Programi SPP i SHBA-ve i ofron Kosovës mundësi të mëdha për ta shtuar eksportin e vet për në SHBA. Më 2008, Kongresi nënshkroi legjislacionin përmes të cilit e vazhdoi programin SPP deri më 31 dhjetor 2009. Programi SPP mundëson hyrjen pa doganë për mbi 4,900 produkte nga vendet përfituese më pak të zhvilluara (VPMPZH) dhe nga vendet e veçanta përfituese në zhvillim (VPZH). Programi SPP ua ofron këtë tretman 131 VPZH-ve dhe territoreve që nga shkurti 2009. Importet në SHBA nën SPP nga të gjithë përfituesit arritën në mbi \$31.7 miliardë më 2008.

Qëllimi i programit SPP është që importeve në SHBA nga vendet në zhvillim t'u jepet përparësi konkurruese në tregun e SHBA-së. Kompanitë dhe konsumatorët e SHBA-së janë në përgjithësi të interesuar në importimin e mallrave nën programin SPP sepse ato nuk ngarkohen me taksë doganore me të hyrë në SHBA, që mund të sillet prej 2 – 17 për qind të kostos së artikujve.

Listat e produkteve të kombinuara të pranueshme sipas SPP-së përfshijnë shumicën e fabrikimeve dhe gjysmëfabrikimeve të doganueshme, dhe produkte të caktuara bujqësore, peshkimi, dhe primare industriale. Disa artikuj janë të ndaluar me statut të SPP-së për të fituar tretman të SPP-së, përfshirë këtu tekstilin e prodhuar nga pambuku, leshin, fibrat sintetike, fibrat e tjera bimore (liri dhe rami); orët, këpucët dhe çantat e caktuara; valixhet; mallrat që nuk janë të punuara nga mëndafshi; dorëzat për punë; dhe artikujt e tjerë të lëkurës.

LLOJET E IMPORTEVE NË SHBA QË PRANUAN TRETMAN PA DOGANË MË 2007



Si fiton një import tretman pa doganë të SPP?

Importi i pranueshëm sipas SPP-së duhet t'i përmbushë kërkesat në vijim:

- Duhet të përfshihet në listën e artikujve¹ të pranueshëm të SPP-së.

¹ Sistemi i tarifave të harmonizuara të SHBA-së gjendet në www.usitc.gov/tata/hts. Vendimet e publikuara për klasifikim mund të gjenden në <http://rulings.cbp.gov>. Informata shtesë lidhur me proceduarat doganore dhe importimin në SHBA gjenden në www.cbp.gov.

- Duhet të importohet në SHBA drejtpërdrejt nga përfituesi i SPP-së apo të kalojë përmes një vendi tjetër në kontejner të mbyllur.
- Artikulli duhet të jetë rritje, produkt apo fabrikim i përfituesit të SPP-së.
- Kur lëndët e para të produkteve importohen jashtë vendit përfitues të SPP-së, shuma e kostos apo e vlerës së materialeve të prodhuara në vendin përfitues, plus kostoja e drejtpërdrejtë e përpunimit, duhet të barazohet me së paku 35 për qind të vlerës së produktit të vlerësuar kur produkti shitet për t'u eksportuar për në SHBA. Materialet e importuara mund të llogariten drejt kërkesës së vlerës së shtuar prej 35 për qind vetëm nëse ato janë “substancialisht të transformuara” në materiale të reja dhe të ndryshme përbërëse që më pas përdoren për të prodhuar apo fabrikuar artikuj të pranueshëm për eksport. “Substancialisht të transformuara” do të thotë që doganat e SHBA-së do t'i klasifikojnë materialet përbërëse si artikuj të ndryshëm.
- Eksportuesi/Importuesi duhet të kërkojë tretman pa doganë nën SPP duke vendosur “A,” “A+,” ose “A*” para numrit të linjës së tarifës së SHBA-së (HTSUS) që i identifikon artikujt e importuar në formularin e deklaratës doganore.

Kufizimet ligjore mbi nevojën konkurruese

Kufizimet mbi nevojën konkurruese (KNK) ofrojnë një kufi mbi dobitë e SPP-së për secilin produkt dhe vend përfitues. Vendi përfitues automatikisht do ta humbasë të drejtën e vet për SPP lidhur me një produkt nëse KNK-të kalohen dhe nëse nuk lejohet heqja dorë. Megjithatë, të gjitha KNK-të u hiqen automatikisht përfituesve të SPP-së të caktuar si VPMPZH.

Përfituesit e SPP-së në asociacione rajonale mund t'i bashkojnë produktet

Programi SPP përmban dispozita të veçanta për vendet përfituese në zhvillim që janë anëtare të një asociacioni rajonal. Asociacioni rajonal konsiderohet si një shtet për qëllime të rregullave të SPP-së për prejardhje. Artikujve të prodhuar në dy apo më shumë vende anëtare të pranueshme të një asociacioni do t'u akordohet tretmani pa doganë nëse vendet, së bashku, i përmbushin rregullat e prejardhjes. Një përfitues më pak i zhvilluar në një asociacion të pranuar rajonal gjithashtu mund të punojë me një vend përfitues jo më pak të zhvilluar në asociacionin rajonal për të prodhuar një prej 1,400 produkteve të rezervuara për prodhim nga përfituesit më pak të zhvilluar. Produkti do të fitojë tretman pa doganë të SPP-së nëse ai transportohet drejtpërdrejt për në SHBA nga vendi më pak i zhvilluar.

Marrëveshjet e SPP-së për artizanate të certifikuar nga tekstili

13 vende përfituese të SPP-së gjithashtu mund t'i eksportojnë disa artikuj të certifikuar të artizanateve pa doganë sipas SPP-së, sepse vendet kanë “marrëveshje për artizanate të certifikuar nga tekstili” me SHBA-në. Marrëveshja i lejon SHBA-së t'u japë tretman pa doganë importeve në SHBA, që janë certifikuar nga vendi përfitues, të tapicerive të punuara në tezgjah dhe të tapicerive për mure; të këllëfëve të punuar në tezgjah dhe të këllëfëve për jastëkë; dhe të disa mbulesave për dysheme nga tekstili të thurura me dorë. Taksat e kursyera sillen prej 3.8 deri në 4.3 për qind.

Keni nevojë për më tepër informata?

Më tepër informata për programin SPP, përfshirë këtu një udhëzues dhe produktet e pranueshme, mund të gjeni në:

http://www.ustr.gov/Trade_Development/Preference_Programs/GSP/Section_Index.html